



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 57

18 prill

2013

PËRMBAJTJA

Vendim i KM
nr. 272, datë 3.4.2013

Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënie për
përdorim me koncesion të burimit ujor “Sasaj” dhe miratimin e
bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet
shoqërisë “Blue Eye One”..... 2505

VENDIM
Nr. 272, datë 3.4.2013

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR
DHËNIEN PËR PËRDORIM ME KONCESION TË BURIMIT UJOR
SASAJ” DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN
PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË
“BLUE EYE ONE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3, dhe 23 pika 3 shkronja “b”, të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie për përdorim me koncesion të burimit ujor “Sasaj”, është Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.
2. Koncesioni do të jetë i formës BOT (ndërtim-shfrytëzim dhe transferim në pronësi të shtetit).
3. Miratimin e bonusit prej 8,5% të pikave, për rezultatin teknik, financiar dhe mjedisor, në procedurën përzgjedhëse konkurruese (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Blue eye one”.
4. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha